



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës / Председник Општине  
Belediye Başkanı

01 Nr. 317/24 Dt. 07.06.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e transferimit të mjeteve financiarë prej 15 % përkatësisht shumë prej 21,568.75 € (kësti i dytë) nga buxheti i Komunës së Prizrenit në kodin buxhetor: Bashkëpunim me donator me nr. 92140 lidhur me realizimin e projektit: “Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kulturës për Zhvillimin e Përbashkët të Turizmit”.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi do të jetë Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 2022/434-320, datë 22.06.2022 dhe 14.07.2022 e nënshkruar ndërmjet Zyrës së Bashkimit Europian në Kosovë, Komunës së Prizrenit, Komunës së Tetovës, CEED Maqedonisë së Veriut dhe CEED të Republikës së Kosovës.
3. Ky projekt realizohet sipas kodit buxhetor, nr. 92140.
4. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Arkivës së Kryetarit.

